




Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE NË: MITROVICË E VERIUT, ZUBIN POTOK, LEPOSAVIQ DHE ZVEÇAN

19 MAJ, 2019



**RAPORTI I VËZHGIMIT TË
ZGJEDHJEVE ZGJEDHJET E
JASHTËZAKONSHME PËR
KRYETAR KOMUNE NË:
MITROVICË E VERIUT, ZUBIN
POTOK, LEPOSAVIQ DHE
ZVEÇAN**

19 MAJ, 2019

Copyright ©2019. Demokracia në Veprim (DnV).

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

Demokracia në Veprim

Rruga "Bajram Kelmendi" nr. 45
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 248 038
www.demokracianeveprim.org

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
KONTEKSTI I MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE	8
KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR	9
ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	10
Funksionimi i institucioneve përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve	10
Kampanjat për informimin dhe edukimin e votuesve.....	12
Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre.....	12
Certifikimi i listës së votuesve	13
Qendrat e Votimit dhe vendvotimet.....	13
Votimi nga jashtë	13
Vëzhguesit e zgjedhjeve.....	14
Drejtësia zgjedhore.....	14
FUSHATA ZGJEDHORE	15
Aktivitetet e fushatës.....	15
Siguria gjatë fushatës	16
Përdorimi i resurseve publike	16
Pjesëmarrja e grave dhe fëmijëve	16
Pjesëmarrja dhe qasja për personat me aftësi të kufizuara.....	17
Prania e mediave.....	17
DITA E ZGJEDHJEVE.....	18
Hapja e vendvotimeve	18
Procesi i votimit	20
Identifikimi i votuesve	20
Problemet me Listën e Votuesve	20
Votimi me asistencë	20
Tentimet për votim të dyfishtë	21
Fotografimi i fletëvotimit.....	21
Votimi familjar	21
Votimi jashtë kabinave.....	21
Prania e personave të paautorizuar në vendvotime.....	22
Mbyllja e vendvotimeve	22
Dalja në zgjedhje e votuesve	23
Votimi me kusht	23
Fletëvotimet e pavlefshme	24
REKOMANDIMET	25
SHTOJCË – Rezultatet e kandidatëve në katër komunat veriore	26
Leposaviq	26
Zubin Potok	26
Zveçan	26
Mitrovicë e Veriut.....	26

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Demokracia në Veprim vlerëson që zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në katër komunitat veriore të Kosovës kanë qenë të qeta dhe nuk janë cenuar nga shkelje të cilat do të ndiknin në integritetin e procesit zgjedhor, apo të cilat mund ta minonin besimin e publikut në to.

Gjatë ditës së zgjedhjeve nuk janë shënuar incidente serioze, por nga vëzhguesit janë regjistruar disa parregullsi gjatë procesit votimit, siç janë: i) Votimi me dokumente të identifikimit të Serbisë; ii) Cenimi i fshehtësisë së votimit, i manifestuar përmes votimit familjar dhe votimit jashtë kabinave; iii) Tentimet për të votuar më shumë se një herë (votimi i dyfishtë); iv) Vështirësitë në gjetjen e votuesve në Listën Përfundimtare të Votuesve, si rezultat i pasaktësisë së tyre; si dhe v) Qasja e kufizuar për personat me aftësi të kufizuara në vendvotime si rezultat i mungesës së infrastrukturës adekuate për persona me aftësi të kufizuar fizike.

Në afërsi të pothuajse të gjitha Qendrave të Votimit ka pasur prani të zyrtarëve policor, të cilët kanë garantuar sigurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të votimit. Prezencë e zyrtarëve të Policisë së Kosovës është hasur edhe në mbi 60% të aktivitetëve të fushatës zgjedhore në këto katër komuna.

Periodha e fushatës zgjedhore ka qenë e qetë dhe pa incidente, por e zbehtë me aktivitete. Subjektet politike dhe kandidatët e tyre nuk kanë organizuar aktivitete të shumta gjatë fushatës. Në përgjithësi, fushata ka pasur karakter promovues të kandidatëve, me vendosje të materialeve promovuese si posterë, banerë dhe shtande informuese. Gjysma e aktivitetëve parazgjedhore kanë qenë tubime publike, shumica dërrmuese e të cilave janë organizuar nga Lista Serbe, me pjesëmarrje relativisht të ulët të qytetarëve. Rreth 50% e aktivitetëve kanë pasur deri në 100 pjesëmarrës. Pjesa më e madhe e të gjitha aktivitetëve është zhvilluar kryesisht në komunën e Leposaviqit dhe atë të Mitrovicës së Veriut.

Gjatë fushatës zgjedhore janë evidentuar parregullsi të caktuara, të tilla si: i) shfrytëzimi i resurseve publike, si veturat zyrtare për qëllime partiake dhe prania e shërbyesve civil në tubime; ii) vendosja e materialeve propaganduese të subjekteve politike dhe kandidatëve në hapësira publike të cilat nuk janë të destinuara për këtë qëllim; v) prania tejet e ulët e grave në aktivitetet e fushatës së subjekteve politike, qoftë si kandidate apo si publik; dhe vi) mungesa e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në pjesën më të madhe të aktivitetëve të zhvilluara.

Në aktivitetet e monitoruara të fushatës zgjedhore nuk është hasur në raste të përdorimit të gjuhës së urrejtje dhe nuk është hasur në përfshirje e fëmijëve në këto aktivitete.

Prania e mediave në tubimet e fushatës zgjedhore ka qenë e kënaqshme dhe të njëjtit nuk janë penguar për të raportuar lirshëm. Sidoqoftë, në bazë të raportimeve, nuk është mbajtur

asnjë debat televiziv ose ndonjë tjerër formë e përbaljes në mes të kandidatëve të subjekteve politike në garë, që në parim ka dëmtuar frymën garuese të fushatës. Si rrjedhojë, qytetarët nuk kanë qenë të ekspozuar ndaj programeve partiake apo ofertave konkurruese për qeverisje lokale.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka realizuar të gjitha aktivitetet e parapara në kuadër të kampanjave për informim dhe edukim të votuesve. Përkundër që këto produkte janë treguar relativisht efikase, mbetet ende punë nga departamenti përkatës i KQZ-së për përmirësimin e cilësisë së informacioneve dhe përmbajtjes të këtyre produkteve. Problem mbetet edhe plasimi i këtyre produkteve në publik, sidomos në rrjetet sociale, ku mund të përdoren metoda inovative dhe më efikase për t'iu qasur publikut.

Në bazë të vëzhgimit të kampanjave informuese dhe të trajnimeve të anëtarëve të Këshillave të Vendotimeve, DnV-ja vlerëson që në mungesë të vëmendjes së shtuar të KQZ-së mbi situatën dhe specifikat e pjesës veriore të vendit, KQZ-ja ka lënë hapësirë që të krijohen dilema sa i përket shkeljeve specifike, siç është identifikimi i votuesve me dokumente jovalide, në këtë rast me dokumente të Serbisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka qenë transparent në njoftimin për mbledhjet e mbajtura dhe publikimin e shumicës së vendimeve të marra. Megjithatë, jo gjithë vëzhguesit e DnV-së kanë pasur qasje në materialet të cilat janë shqyrtuar nga anëtarët e KQZ-së, deri pas publikimit të tyre.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka vepruar me profesionalizëm dhe në mënyrë të paanshme në trajtimin e ankesave, duke respektuar afatet kohore. Në këtë drejtim, ky institucion ka shqyrtuar ankesat e DnV-së lidhur me vendosjen e materialeve propaganduese të subjekteve politike në hapësira të palejuara publike

KONTEKSTI I MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të komunave Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, janë shpallur si pasojë e dorëheqjeve të katër kryetarëve të këtyre komunave më 27 nëntor të vitit 2018.

Në një mbledhje të jashtëzakonshme, të mbajtur po atë ditë, ish-kryetarët e katër komunave në veri të vendit kishin nënshkruar një deklaratë, në të cilën paraqiteshin dorëheqjet e tyre, të bazuara në katër pika të arsyeshmërisë, e të cilat ndërlidheshin kryesisht me vendimin e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e taksës prej 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Letrat e dorëheqjes ishin dorëzuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal disa ditë pas, mirëpo të njëjtat nuk ishin pranuar nga ana e Qeverisë së Kosovës, për shkak të referimeve dhe denominimeve jokushtetuese që ishin përdorur në vendimin për dorëheqjet e tyre.

Shpallja e këtyre zgjedhjeve është bërë më 8 prill të vitit 2019 nga ana e Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, pas një vonese prej më shumë se katër muajsh, që kishte ardhur si rezultat i paqartësive lidhur me ligjshmërinë e letrave të dorëheqjes së kryetarëve. Në vendimin e Presidentit [Për më shumë, shih: <https://telegrafi.com/presidenti-shpall-zgjedhjet-per-kryetare-te-kater-komunave-veriore/> [Qasur më 27 maj, 2019]], ishte përmendur edhe shkresa e dërguar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila kishte dhënë interpretimin ligjor për shpalljen e këtyre zgjedhjeve.

Sipas vendimit, zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të këtyre katër komunave ishin caktuar që të mbahen më 19 maj të vitit 2019.

KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Sistemi zgjedhor në Republikën e Kosovës është i përcaktuar me Kushtetutën e vendit dhe i definuar me ligje specifike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e asociimit si dhe të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Korniza ligjore e cila rregullon në detaje organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në vend janë Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Zgjedhjet Lokale, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike si dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) si organ menaxhues i zgjedhjeve po ashtu ka të miratuara rregullat zgjedhore të cilat rregullojnë aspekte specifike të procesit zgjedhor.

Për zgjedhjet e nivelit lokal, përkatësisht zgjedhjet për kryetarë të komunave, Republika e Kosovës aplikon sistem zgjedhor pluralist/mazhoritar, ku votohet vetëm për një kandidat. Kosova është e ndarë në 38 zona zgjedhore, ku secila komunë paraqet zonë të veçantë zgjedhore, që nënkupton se kandidatët mund të votohen vetëm nga qytetarët e komunës në fjalë.

Në zgjedhjet për kryetarë të komunës nuk aplikohet prag zgjedhor, por parashihet sistem me dy raunde të zgjedhjes (balotazh) në rast se asnjëri nga kandidatët nuk arrin të sigurojë 50%+1 të votave në raundin e parë. Për këto lloj zgjedhesh, nuk aplikohet kuota gjinore.

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Funksionimi i institucioneve përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve

Marrë parasysh natyrën e jashtëzakonshme dhe afatet e shkurtuara për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, Demokracia në Veprim vlerëson që KQZ-ja ka arritur që të përmbushë në masë të madhe të gjitha standardet për organizimin dhe administrimin e rregullt të procesit zgjedhor.

Që nga shpallja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat veriore, deri në certifikimin e rezultateve përfundimtare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka mbajtur gjithsej 18 mbledhje të rregullta. Këto mbledhje janë mbajtur në frymë bashkëpunimi profesional në mes anëtarëve të KQZ-së, si dhe pa mospajtime të thella, me përjashtim të mbledhjes kur ishte votuar për moscertifikimin e kandidatëve të Listës Serbe, ku kishte pasur tensione.

Në mbledhjen e parë pas shpalljes së zgjedhjeve, KQZ-ja kishte miratuar planin e aktiviteteve zgjedhore, në të cilin ishin paraparë afatet kryesore për realizimin e tyre². Ndërsa, në një nga mbledhjet e radhës, KQZ-ja kishte miratuar planin e detajuar operacional për këto zgjedhje³. Buxheti i ndarë për organizimin dhe administrimin e këtyre zgjedhjeve, duke përfshirë edhe raundin e dytë, ishte 475,193 euro. Më tutje, KQZ-ja kishte miratuar vendimin për kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklaratimet, sipas të cilit, bazuar në aktet ligjore në fuqi, mund të shpenzohen 0,50 cent për votues. Shuma e përgjithshme që subjektet politike ishin të lejuara të shpenzojnë, arrin vlerën rreth 30 mijë euro.

Pothuajse të gjitha mbledhjet kanë qenë të paralajmëruara në faqen elektronike të KQZ-së, mirëpo vendimet e marra gjatë mbledhjeve janë publikuar me vonesë. Problematikë e ngjashme mbetet mostransparenca e këtij institucioni, sa i përket ndarjes së materialeve me të gjithë vëzhguesit e mbledhjeve të KQZ-së.

Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) kanë mbajtur aktivitetet e tyre të rregullta, të paracaktuara me planin operacional të KQZ-së. Numri i mbledhjeve mbetet i ulët, kryesisht si rezultat i afateve të shkurtuara kohore. Në këto zgjedhje, KKZ-të kanë qenë të fokusuar kryesisht në organizimin e trajnimeve për anëtarët e këshillave të vendotimeve, vizitat nëpër qendrat e

² Për më shumë, shih vendimin: www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/04/2019-04-08-Caktimi-i-afateve_al.pdf [Qasur më 27 maj, 2019]

³ Për më shumë, shih vendimin dhe Planin Operacional: http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/04/2019-04-10_AL_266-2019-Vendim-per-miratimin-e-planit-operacional-per-zgjedhjet-e-jashtezakonshme-per-Kryetare-ne-kater-Komuna.pdf [Qasur më 27 maj, 2019]

votimit dhe vendvotimet përkatëse, pranimin dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore, gjegjësisht përgatitjen e vendvotimeve për procesin zgjedhor. Sa i përket trajnimeve të anëtarëve të KVV-ve, në këto zgjedhje ato kanë zgjatur tri ditë, dhe sipas vëzhguesve të DnV-së, të gjithë anëtarët e KVV-ve janë trajnuar sipas materialeve të parapara. Megjithatë, problem mbetet moszbatimi i njohurive të ofruara gjatë trajnimeve, në ditën e zgjedhjeve nga ana e këtyre komisionerëve të trajnuar.

Bazuar në informatat e paraqitura në kampanjat informuese të KQZ-së, të cilat janë përdorur edhe gjatë trajnimeve të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve, DnV-ja vlerëson që në mungesë të vëmendjes së shtuar të KQZ-së mbi situatën dhe specifikat e pjesës veriore të vendit, është lënë hapësirë që të krijohen dilema sa i përket shkeljeve të caktuara, sidomos për dokumentet e vlefshme për identifikimin e votuesve. Në fund të pothuajse të gjitha trajnimeve, janë organizuar testime për pjesëmarrësit.

Një nga problemet kryesore me KKZ-të mbetet organizimi i mbledhjeve, të cilat në të shumtën e rasteve nuk bëhen të ditura për publikun e gjerë, si dhe procesverbalet e tyre nuk publikohen.

Qendra për Numërim dhe Rezultate (QNR) ka qenë përgjegjëse për administrimin të numërimit të votave me kusht, votave me postë, si dhe votave të personave me nevoja të veçanta. Ky proces ka filluar më 21 maj, kur ishin numëruar votat me postë dhe ishin verifikuar zarfet e votimeve me kusht. Ndërsa, më 22 maj është bërë numërimi i fletëvotimeve me kusht. Stafi i angazhuar në këtë proces ka qenë profesional dhe është siguruar përfshirja e komuniteteve jo-shumicë. Vëzhguesit e procesit të numërimit janë njoftuar paraprakisht për numërimin në QNR dhe të njëjtëve iu janë ofruar të gjitha informatat dhe materialet e nevojshme.

Sa i përket administrimit të procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja kishte marrë vendim për përfshirjen e misionit të OSBE-së në Kosovë, por duke e kufizuar atë vetëm në ofrimin e këshillave teknike për Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve.

KAMPANJAT PËR INFORMIMIN DHE EDUKIMIN E VOTUESVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka realizuar të gjitha aktivitetet e parapara në kuadër të kampanjave për informim dhe edukim të votuesve. Për këto aktivitete, në buxhetin e paraparë për organizimin e këtyre zgjedhjeve, ishin ndarë rreth 43 mijë euro. Përkundër që produktet informuese të kësaj kampanje, si banerët, posterët, video spotet publicitare dhe animacionet e ndryshme, janë treguar relativisht efikase, mbetet ende punë nga departamenti përkatës i KQZ-së për përmirësimin e cilësisë së informacioneve dhe përmbajtjes të këtyre materialeve informuese. Rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e aktiviteteve lidhur me informimin publik ka pasur krijimi i Këshillit Mbikëqyrës për Operacionet e Informimit Publik në kuadër të KQZ-së, i cili në vazhdimësi ka përcjellë aktivitetet e zhvilluara nga Sekretariati.

Ende problem mbetet plasimi i këtyre produkteve në publik, sidomos në rrjetet sociale, ku nuk janë përdorur metoda inovative, të cilat mund të jenë më efikase për t'iu qasur publikut.

Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre

Bazuar në vendimin e KQZ-së për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore, afati i aplikimit për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave veriore, filloi më 9 dhe përfundoi më 18 prill. Ndërsa, certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve ishte paraparë të bëhet më 22 prill. KQZ-ja ka certifikuar gjithsej 3 subjekte politike me nga gjithsej 12 kandidatë.

Në mbledhjen e 23 prillit, KQZ-ja kishte marrë vendim për certifikimin e kandidatëve të dy subjekteve politike – Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Përkundër rekomandimit pozitiv të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, KQZ-ja nuk kishte certifikuar kandidatët e subjektit politik Lista Serbe, si rezultat i mungesës së numrit të nevojshëm të votave, si dhe përplasjeve verbale në mes të anëtarëve të Komisionit lidhur me këtë temë. Ky vendim ishte ankimuar nga Lista Serbe në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), që më 25 maj kishte nxjerrë vendim për pranimin e pjeshëm të apelit të Listës Serbe, duke urdhëruar KQZ-në të certifikojë subjektin politik në fjalë. Megjithatë, edhe pas vendimit të Panelit, në mbledhjen në vijim kishin vazhduar mospajtimet, në veçanti mes përfaqësuesve të Listës Serbe dhe Lëvizjes Vetëvendosje, meqenëse këta të fundit kundërshtonin certifikimin e kandidatëve pa pasur një vendim të organeve gjyqësore mbi vlefshmërinë juridike të akteve të dorëheqjes.

Shorti për renditjen e subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotim ishte hedhur më 30 prill. Subjekti i parë në fletëvotim, me numër 60, u caktua të jetë Lëvizja Vetëvendosje, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me numër 61, si dhe Lista Serbe me numër 62.

Certifikimi i listës së votuesve

Lista përfundimtare e votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të komunave në veri të vendit, përmban gjithsej 57,983 votues, me një rritje prej 970 votuesish krahasuar me zgjedhjet e fundit të nivelit lokal, të mbajtura më 22 tetor të vitit 2017. Bazuar në ndarjen sipas komunave, të drejtë vote në komunën e Mitrovicës së Veriut kanë 22,055 qytetarë, pasuar nga Leposaviqi me 18,164, Zveçani me 9,229 dhe Zubin Potoku me 8,535 votues. Në përgjithësi, numri i votuesve që kanë fituar për herë të parë të drejtën e votës (kanë mbushur 18 vjeç) është 352 votues. Ndërsa, 1,063 persona janë hequr nga lista e votuesve, duke përfshirë personat e vdekur, personat që kanë hequr dorë nga shtetësia dhe votuesit që kanë ndërruar adresë nga këto komuna në komunat tjera të Kosovës.

Qendrat e Votimit dhe vendvotimet

Procesi i votimit në këto komuna është zhvilluar në gjithsej 44 Qendra të Votimit, përkatësisht 87 vendvotime. Komuna e Leposaviqit ka pasur 18 Qendra të Votimit me 31 vendvotime, komuna e Zubin Potokut – 12 Qendra të Votimit me 16 vendvotime, komuna e Zveçanit – 7 Qendra të Votimit me 13 vendvotime, si dhe komuna e Mitrovicës së Veriut – 7 Qendra të Votimit me 27 vendvotime. Në këto zgjedhje është shtuar një pikë e re e votimit në fshatin Çabër, në komunën e Zubin Potokut.

Votimi nga jashtë

Në planin bazë të afateve për aktivitetet zgjedhore, ishte paraparë që periudha për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës të zgjasë nga data 25 prill deri më 30 prill. Sidoqoftë, me anë të një vendimi të KQZ-së⁴ kjo pikë ishte ndryshuar, duke dhënë dy ditë më shumë afat, përkatësisht nga data 23 deri më 30 prill.

Për t'u regjistruar si votues jashtë vendit kanë aplikuar gjithsej 1,058 persona, prej të cilëve 1,056 ishin nga Serbia, ndërsa dy persona tjerë nga Mali i Zi. Nga numri i përgjithshëm i aplikacioneve, 793 sosh janë pranuar, ndërsa pjesa tjetër, përkatësisht 263 aplikacione, janë refuzuar për arsye të mosdëshmimit të identitetit, mosdëshmimit të kriterëve të zotësisë juridike, apo për shkak se aplikuesit nuk kanë qenë nga komunat në të cilat janë mbajtur zgjedhjet. Pas përfundimit të procesit të votimit jashtë vendit, KQZ ka pranuar gjithsej 742 pliko, prej të cilave tri janë refuzuar, ndërsa pjesa tjetër është proceduar për numërim.

Nga gjithsej 739 fletëvotime të pranuar, 347 sosh ishin për komunën e Mitrovicës së Veriut, 256 për komunën e Leposaviqit, 76 për komunën e Zubin Potokut dhe 60 për komunën e Zveçanit. Të gjitha fletëvotimet ishin të vlefshme, ndërsa të gjitha votat kanë qenë për kandidatët e subjektit politik Lista Serbe.

⁴ Për më shumë, shih vendimin: http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/04/2019-04-19_Vendim-caktimin-e-afateve-te-aktiviteteve_al.pdf [Qasur më 27 maj, 2019]

Vëzhguesit e zgjedhjeve

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, më 15 maj i kishte rekomanduar KQZ-së akreditimin e 464 vëzhguesve, nga gjithsej 39 organizata. Prej tyre, për të vëzhguar procesin e votimit janë akredituar dy parti politike me gjithsej 129 vëzhgues, dy misione ndërkombëtare me gjithsej 14 vëzhgues, Komisioni Evropian me dy vëzhgues, dy misione diplomatike me gjithsej tre vëzhgues, 12 ambasada në Kosovë me gjithsej 55 vëzhgues, një OJQ ndërkombëtare me 15 vëzhgues, katër OJQ vendore me gjithsej 165 vëzhgues, si dhe 15 kompani të mediave me gjithsej 81 vëzhgues.

Drejtësia zgjedhore

Në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) janë dorëzuar gjithsej pesë ankesa dhe një apel gjatë tërë procesit zgjedhor. Apeli është parashtruar para procesit zgjedhor, përkatësisht lidhur me moscertifikimin e Listës Serbe nga KQZ-ja. Kurse, nga numri i përgjithshëm i ankesave, tri prej tyre janë parashtruar nga Demokracia në Veprim (DnV) lidhur me vendosjen e materialeve promovuese të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre në hapësira të palejuara, që janë vlerësuar si shkelje gjatë fushatës zgjedhore, kurse dy ankesa tjera janë parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Interneës Kosova, lidhur me ditën e votimit, përkatësisht lidhur me identifikimin e votuesve me dokumente të Serbisë, por të cilat janë vlerësuar si të parregullta, si rezultat i mosfrimit të provave shtesë, të kërkuara nga Paneli⁵.

Shuma e gjobave lidhur me ankesat për periudhën e fushatës zgjedhore, të parashtruara nga DnV-ja, kapin vlerën e 6,150 Euro⁶.

Sa i përket ditës së zgjedhjeve dhe rezultateve përfundimtare nuk është parashtruar asnjë ankesë, duke i hapur kështu rrugë certifikimit të rezultateve përfundimtare.

⁵Për më shumë, shih vendimin: <http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/05/A5-Vendim.pdf> [Qasur më 30 maj, 2019]

⁶Për më shumë, shih vendimet: <http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/05/A4-Vendim.pdf> [Qasur më 30 maj, 2019]

<http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/05/A3-Vendimi.pdf> [Qasur më 30 maj, 2019]

<http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/05/A2-Vendimi.pdf> [Qasur më 30 maj, 2019]

FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 19 majit, për kryetarë të komunave Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, ka zgjatur pesë ditë, në periudhën 13 deri më 17 maj.

Demokracia në Veprim ka monitoruar periudhën pesë-ditore të fushatës zgjedhore në katër komunat, me anë të katër vëzhguesve afatgjatë, të cilët kanë raportuar mbi aktivitetet e monitoruara, në baza ditore. Vëzhguesit kanë monitoruar vendosjen e materialeve promovuese nga subjektet politike, si dhe mbledhjet e mbajtura të Komisioneve Komunale Zgjedhore.

Në këto zgjedhje, fushatë kanë zhvilluar gjithsej tri subjekte politike, prej të cilave një ishte serbe ndërsa dy të tjera shqiptare. Duke marrë parasysh kompozicionin demografik të këtyre komunave, Demokracia në Veprim konsideron që garimi i vetëm një subjekti politik serb nënkupton që nuk ka pasur garë të mirëfilltë elektorale dhe politike në mes të subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb. Rrjedhimisht, para qytetarëve nuk janë shpalosur platforma dhe programe partiake të cilat do të përmbanin alternativa dhe zgjidhje mbi problemet me të cilat ata ballafaqohen.

■ AKTIVITETET E FUSHATËS

Vëzhguesit e DnV-së kanë monitoruar gjithsej 40 aktivitete paralajmëruara të subjekteve politike në katër komunat veriore të vendit, pjesa më e madhe e të cilave kanë qenë tubime publike të mesme dhe të vogla, me deri 100 pjesëmarrës. Shtatë tubime kanë qenë të mëdha me deri në 500 pjesëmarrës, ndërsa vetëm tri aktivitete tjera kanë pasur më shumë se 1,000 pjesëmarrës.

Në përgjithësi, fushata zgjedhore është zhvilluar e qetë dhe pa incidente. Fushatë është zhvilluar më së shumti nga ana e Listës Serbe, e cila ka koncentruar aktivitetet në komunën e Leposaviqit dhe atë të Mitrovicës së Veriut. Në anën tjetër, subjektet politike shqiptare kanë organizuar vetëm tri tubime të vogla, të cilat janë zhvilluar në zonat e banuara me shqiptarë.

Dy ditët e para të fushatës zgjedhore janë karakterizuar me numër relativisht të vogël të aktiviteteve të zhvilluara, të cilat kanë pasur kryesisht natyrë promovuese të kandidatëve, duke përfshirë vendosjen e posterëve, banerëve apo pikave tjera informuese, si dhe takimeve me qytetarë në qytetet respektive. Fushata ka shënuar një intensifikim të lehtë në ditët e fundit, veçanërisht në ditën e fundit, në të cilën Lista Serbe ka organizuar tubime përmbyllëse me pjesëmarrje më të madhe qytetare, krahasuar me ditët tjera të fushatës. Në ditën e fundit të

fushatës, në komunën e Mitrovicës së Veriut, ka pasur vendosje të materialeve promovuese në hapësira të palejuara, nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Vlen të përmendet që në një aktivitet të organizuar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në zyrat e këtij subjekti në komunën e Mitrovicës së Veriut, vëzhguesit të DnV-së nuk i është lejuar pjesëmarrja. Sidoqoftë, pas përfundimit të këtij aktiviteti, pjesëmarrësit kanë brohoritur "UÇK" në 'Lagjen e Boshnjakëve'.

Gjuha e urrejtjes nuk është evidentuar në asnjë nga aktivitetet e monitoruara nga DnV-ja.

SIGURIA GJATË FUSHATËS

Për sigurinë e mbi 60% e aktiviteteve të zhvilluara është kujdesur Policia e Kosovës, e cila sipas raportimeve, ka qenë profesionale gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Në pjesën tjetër të aktiviteteve nuk ka pasur fare sigurim, si dhe nuk është evidentuar ndonjë rast kur për sigurinë janë kujdesur pjesëtarët e EULEX-it, KFOR-it apo truprojave të armatosura.

PËRDORIMI I RESURSEVE PUBLIKE

Gjatë fushatës parazgjedhore janë evidentuar disa raste të përdorimit të resurseve publike. Përdorimi i veturave zyrtare është parë nga vëzhguesit në dy raste, në aktivitetet e Listës Serbe në komunën e Zubin Potokut dhe një rast tjetër i pjesëmarrjes së shërbyesve civil në aktivitetet e subjektit të njëjtë politik në Zubin Potok.

PJESËMARRJA E GRAVE DHE FËMIJËVE

Prania e grave në aktivitetet e fushatës zgjedhore vazhdon të mbetet e ulët, ngjashëm sikur edhe proceseve të kaluara zgjedhore. Në këtë fushatë, gratë kanë marrë pjesë në vetëm rreth 15% të aktiviteteve të zhvilluara. Kurse, nga gjithsej mbi 70 fjalime sa janë mbajtur gjatë aktiviteteve të fushatës, vetëm 12 prej tyre janë mbajtur nga gratë. Pjesa më e madhe e fjalimeve nga gratë janë mbajtur nga vetë dy kandidatet që garojnë në pozitën e kryetarëve në komunën e Mitrovicës së Veriut dhe atë të Zveçanit.

Përfshirja e fëmijëve gjatë fushatës, si dukuri e cila ka shoqëruar zgjedhjet paraprake, ka shënuar përmirësim të ndjeshëm. Gjatë kësaj fushate, nga vëzhguesit e DnV-së nuk është evidentuar asnjë rast i përfshirjes së fëmijëve në aktivitete, qoftë spontanisht apo në mënyrë të organizuar.

■ Pjesëmarrja dhe qasja për personat me aftësi të kufizuara

Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në fushatë ka qenë tejet e ulët, ku prezent ka qenë vetëm një person në gjithsej 40 aktivitete. Në vetëm në dy nga aktivitetet e zhvilluara është siguruar qasje për personat me aftësi të kufizuar. Një numër kaq i ulët ndërlidhet edhe me natyrën atipike të kësaj fushate, e cila për dallim nga herët e kaluara, ka qenë kryesisht e orientuar në promovim të kandidatëve, nëpërmjet vendosjes së posterëve, banerëve dhe shtandeve informuese.

■ Prania e mediave

Mediat kanë qenë të pranishme në 25%, përkatësisht 10 nga 40 aktivitetet zgjedhore të monitoruara në këto katër komuna. Në të gjitha rastet kur ka pasur mbulim medial, mediat kanë qenë të lira të raportojnë lirshëm.

DITA E ZGJEDHJEVE

Hapja e vendvotimeve

Bazuar në të dhënat e vëzhguesve të DnV-së në ditën e zgjedhjeve, të gjitha vendvotimet janë hapur me kohë në të gjitha qendrat e votimit në katër komunat veriore. Madje, një vendvotim në komunën e Mitrovicës së Veriut dhe një në atë të Zveçanit janë hapur rreth 10 minuta para kohe, pasi që ka pasur votues të cilët kanë shprehur interesim për të votuar.

Prania e materialeve propaganduese në afërsi të Qendrave të Votimit, në një perimetër prej 100 metrash, është evidentuar në rreth 11% të Qendrave të Votimit, përkatësisht 5 sosh. Nga dy raste janë evidentuar në komunën e Leposaviqit dhe atë të Mitrovicës së Veriut, ndërsa një rast është evidentuar në komunën e Zveçanit.

Personat me aftësi të kufizuara kanë pasur qasje në vetëm 26.44% të vendvotimeve, gjegjësisht në 23 nga gjithsej 87 vendvotimet. Komuna e Leposaviqit prin me numrin më të madh të vendvotimeve në të cilat nuk ka pasur infrastrukturë adekuate për votim të personave me aftësi të kufizuara.

Sa i përket numrit të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve nëpër komuna, vëzhguesit kanë raportuar për rreth 600 komisionerë të angazhuar, me një mesatare prej rreth 7 komisionerë për secilin vendvotim.


Përfshirja e grave në administrimin e procesit zgjedhor mbetet ende nën nivelin prej 40%, që është dakorduar në mes të subjekteve politike në vend⁷. Rreth 200 gra, apo shprehur në përqindje – rreth 35%, kanë qenë të angazhuara si anëtare të Këshillave të Vendvotimit. Në gjithsej katër vendvotime në këto katër komuna nuk ka pasur fare komisionere gra.

Në të gjitha vendvotimet është raportuar se nuk ka munguar asnjë nga materialet zgjedhore, si dhe është siguruar transparencë e plotë në aspektin e sigurisë së administrimit të procesit zgjedhor, meqenëse pra fillimit të procesit të votimit, kutitë kanë qenë të zbrazëta dhe të mbyllura me shirita të sigurisë, numrat serik të të cilëve janë regjistruar në librin përkatës. Kabinat e votimit janë vendosur në pozitë që siguron fshehtësinë e votës.

⁷ Për më shumë, shih Deklaratën për Rritjen e Pjesëmarrjes së Grave në Proceset Zgjedhore, të nënshkruar nga partitë kryesore politike në vend: <http://botapress.info/rritja-e-pjesemarrjes-se-grave-ne-proceset-zgjedhore/> (Qasur më 30 maj, 2019)

26.44%

TË QASSHME



Vendvotimet me
qasje për personat
me aftësi të
kufizuara

TË PAQASSHME

73.56%

Procesi i votimit

IDENTIFIKIMI I VOTUESVE

Çështja e identifikimit të votuesve, në një numër të konsiderueshëm të rasteve, është përcjellë me paqartësi nga anëtarët e këshillave të vendvotimeve, të cilët kanë lejuar që votuesit, të cilët kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve, të identifikohen me dokumente të identifikimit të Serbisë. Përkundër deklarimeve të KQZ-së gjatë ditës së zgjedhjeve që dokumentet e vetme të vlefshme për identifikimin e votuesve duhet të jenë dokumentet e Republikës së Kosovës, në së paku 100 raste në 17 vendvotime të ndryshme, vëzhguesit e DnV-së kanë evidentuar identifikimin e votuesve me dokumente të Serbisë.

Megjithatë, bazuar në raportimet e vëzhguesve afatshkurtër të DnV-së, në 14 vendvotime të ndryshme në këto katër komuna, 181 qytetarë janë refuzuar që të votojnë për shkak të dokumenteve të prezantuara për identifikim. Pjesa më e madhe e këtyre rasteve, përkatësisht 134 sosh, janë evidentuar në komunën e Zveçanit.

PROBLEMET ME LISTËN E VOTUESVE

Ngjashëm sikur edhe në proceset e kaluara, pasaktësia e Listës Përfundimtare të Votuesve mbetet problem që kërkon adresim sa më të shpejtë nga ana e institucioneve përkatëse. Faktor mjaft domethënës në këtë drejtim mbetet edhe mungesa e sistemit të unifikuar i adresave të banimit, që ka rezultuar me caktim të votuesve nëpër Qendra të Votimit larg vendbanimeve të tyre.

Në ditën e zgjedhjeve, problemi i pasaktësisë së listës së votuesve ka qenë i shprehur në 39% të vendvotimeve, me rreth 300 votues të cilët nuk e kanë gjetur emrin në listën e votuesve. Në kuadër të kësaj shifre, më së shumti raste janë hasur në komunën e Mitrovicën e Veriut dhe atë të Zveçanit, me 98, respektivisht 97 raste kur votuesit nuk kanë gjetur emrin në listën e votuesve. Pas tyre renditet Leposaviqi, në vendvotimet e së cilës komunë janë evidentuar 58 votues të cilët nuk kanë gjetur emrin e tyre në listën e votuesve, si dhe Zubin Potoku me vetëm 42 raste.

VOTIMI ME ASISTENCË

Sipas legjislacionit në fuqi, votimi me asistencë është i lejuar si veprim, mirëpo që duhet respektuar disa rregulla të ndryshme, të cilat përcaktojnë që i njëjti person nuk mund të asistojë më shumë se një herë, si dhe i njëjti duhet regjistruar në Librin e Votimit.

Në zgjedhjet e 19 majit, vëzhguesit e DnV-së kanë evidentuar gjithsej 208 raste të votimit me asistencë. Ky numër paraqet më pak se 1% të numrit të përgjithshëm të votuesve të cilët kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës. Rastet më të shpeshta të votimit me asistencë janë hasur në komunën e Leposaviqit (80), pasuar nga komuna e Zveçanit (53), komuna e Mitrovicës së Veriut (39), si dhe komuna e Zubin Potokut (36). Ky lloj i votimit ka ndodhur në mbi 50% të vendvotimeve, konkretisht në 44 nga gjithsej 87 vendvotimet në katër komunat veriore.

■ TENTIMET PËR VOTIM TË DYFISHTË

Tentimet për votim të dyfishtë kanë shënuar ulje të ndjeshme krahasuar me proceset e kaluara zgjedhore në përgjithësi, kur kjo parregullsi ka qenë dukshëm më e shprehur. Në ditën e zgjedhjeve, nga vëzhguesit e DnV-së janë raportuar vetëm dy raste të tentimit për votim të dyfishtë. Rastet kanë ndodhur në vendvotimin 1206B/01D, në komunën e Leposaviqit, si dhe në vendvotimin 3803B/01R në komunën e Mitrovicës së Veriut. Në këto raste, votuesve u janë gjetur shenja të spërkatësit në gishtërinj.

■ FOTOGRAFIMI I FLETËVOTIMIT

Rasti i vetëm kur dikush ka tentuar të fotografojë fletëvotimin është raportuar në fshatin Banjaskë të komunës së Zveçanit, përkatësisht në vendvotimin 2912B/01D. Në vendvotimet tjera nuk është raportuar për raste të tilla.

■ VOTIMI FAMILJAR

Dukuria më e shpeshtë e cila ka shoqëruar pothuajse të gjitha proceset zgjedhore në Kosovës, është votimi familjar, që ndodh atëherë kur dy a më shumë persona, nën arsyetimin e afërsisë familjare apo ofrimit të asistencës, votojnë njëkohësisht në një kabinë të vetme të votimit. Një dukuri e tillë cenon fshehtësinë e votës, pasi që u pamundëson votuesve votimin në pavarësi të plotë.

Kjo parregullsi është raportuar në vetëm shtatë vendvotime, në të cilat janë hasur së paku 23 raste. Tri nga këto vendvotime ndodhen në komunën e Zveçanit, tri të tjera në komunën e Mitrovicës, ndërsa një vendvotim tjetër në komunën e Zubin Potokut.

VOTIMI JASHTË KABINAVE

Lloj tjetër i votimit, i cili cenon parimin e fshehtësisë e votës është votimi jashtë hapësirës së caktuar për votim, të cilat janë kabinat e votimit. Rreth pesë raste të parregullsive të tilla të votimit janë vënë re në katër vendvotime të ndryshme, tri prej të cilave në komunën e Leposaviqit, ndërsa një tjetër në komunën e Zveçanit.

PRANIA E PERSONAVE TË PAAUTORIZUAR NË VENDVOTIME

Gjatë ditës së zgjedhjeve, nuk është raportuar për asnjë rast kur në vendvotime ka pasur prani të personave të paautorizuar, të cilët nuk kanë pasur akreditimet përkatëse.

Mbyllja e vendvotimeve

Mbyllja e pothuajse të gjitha vendvotimeve është bërë në kohë dhe nuk është regjistruar ndonjë parregullsi. Përjashtim bëjnë katër vendvotime, të cilat janë mbyllur me disa minuta vonesë, pasi që votuesit që kanë qenë në radhë duke pritur për të votuar para orës 19:00, janë lejuar që të votojnë. Në asnjë nga vendvotimet në katër komunat veriore nuk është hasur prezencë e personave të paautorizuar gjatë procesit të numërimit. Mbarëvajtja e procesit të numërimit ka qenë e rregullt dhe nuk është shoqëruar me incidente. Po ashtu, të gjithë të pranishmit nëpër vendvotime janë pajtuar me rezultatet përkatëse.

Dalja në zgjedhje e votuesve


Bazuar në rezultatet përfundimtare të KQZ-së⁸, të drejtën e votës e kanë ushtruar 25,288 votues, nga gjithsej 58,778 votuesit e regjistruar, duke përfshirë edhe votimin me postë, me kusht dhe votimin e personave me nevoja të veçanta. Në përqindje, pjesëmarrja në nivel të katër komunave është 43.02%.


Komuna me nivelin më të lartë të pjesëmarrjes është Zubin Potoku me 51.07%, pasuar nga Zveçani me 45.30%, Leposaviqi me 42.53% dhe Mitrovica e Veriut me 39.38%.


Në tabelën në vijim janë të paraqitura të dhënat për numrin e votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komunat në veri të vendit, si dhe pjesën tjetër të votuesve të cilët nuk kanë votuar.

⁸ Për më shumë, shih vendimin dhe rezultatet përfundimtare: http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2019/05/Vendim-per-shpalljen-e-rezultateve-perfundimtare-te-zgji-te-jash-tezakonshme-ne-kater-komuna_23-05-2019_0247_1_al.pdf [Qasur më 28 maj, 2019]

DALJA NË ZGJEDHJE

 Numri i votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje

 Numri i votuesve që NUK kanë marrë pjesë në zgjedhje




VOTIMI ME KUSHT

Votimi me kusht në veçanti, por dhe votimi i personave me nevoja të veçanta, si forma alternative të votimit, kanë qenë dukshëm të shprehura në zgjedhjet jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave veriore të vendit. Në Qendrën e Numërimeve dhe Rezultateve janë pranuar gjithsej 491 zarfe, prej të cilave 483 vota me kusht dhe tetë vota nga personat me nevoja të veçanta. Pas procesit të verifikimit, vetëm 114 prej tyre janë konfirmuar, ndërsa gjithsej 377 janë refuzuar, për shkak se votuesit kanë votuar me kusht dhe në vendvotime të rregullta (8 raste), votuesit kanë votuar me kusht dhe kanë qenë të regjistruar si votues jashtë Kosovës (8 raste), votuesit kanë votuar me kusht ndonëse kanë qenë të regjistruar si votues në komuna tjera (46 raste), apo për shkak se votuesit kanë votuar me kusht, pa qenë fare në Listën Përfundimtare të Votuesve (315 raste). Pjesa më e madhe e këtyre parregullsive janë evidentuar në komunën e Mitrovicës së Veriut.

Nga numri i përgjithshëm i votave të konfirmuara me kusht, 60 prej tyre janë për komunën e Mitrovicës së Veriut, 27 për komunën e Leposaviqit, 22 për komunën e Zveçanit dhe vetëm pesë për komunën e Zubin Potokut.

VOTAT ME KUSHT SIPAS KOMUNAVE

■ Të konfirmuara
■ Të refuzuara



FLETËVOTIMET E PAVLEFSHME

Një nga problemet me të cilat është shoqëruar organizimi i zgjedhjeve në Kosovë, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror është numri i madh i fletëvotimeve të pavlefshme. Përkundër përpjekjeve të shumta për evidentimin dhe evitimin e faktorëve që rezultojnë me numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, edhe në këto zgjedhje ka vazhduar trendi i njëjtë me këtë fenomen.

Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme në nivel të katër komunave, për këto zgjedhje është 683. Komuna e Leposaviqit dhe ajo e Mitrovicës së Veriut kanë nga 240 fletëvotime të pavlefshme secila. Në komunën e Zveçanit janë evidentuar 121 fletëvotime të pavlefshme, ndërsa në komunën e Zubin Potokut janë evidentuar vetëm 82 sosh. Parë në përqindje, numri i përgjithshëm fletëvotimeve të pavlefshme në katër komunat është 1.16%.

Komuna e Leposaviqit, me 3.06%, prin me përqindjen më të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme, që është pothuajse trefishi i mesatares së përgjithshme në katër komunat veriore. Pas saj renditen komuna e Zveçanit me 2.87%, komuna e Mitrovicës së Veriut me 2.71% dhe komuna e Zubin Potokut me 1.86%.

REKOMANDIMET

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, Demokracia në Veprim ofron rekomandimet si në vijim, të cilat do të ndikonin në përmirësimin e proceseve të ardhshme zgjedhore:

- ☑ Në demokracitë e shëndetshme, partitë politike duhet t'i kontribuojnë frymës konkurruese së zgjedhjeve dhe t'a bazojnë fushatën e tyre në platforma dhe programe konkrete politike. Një garë e mirëfilltë do t'u ofronte qytetarëve mundësi të zgjedhin midis alternativave të ndryshme qeverisëse, do të siguronte gjithpërfshirje dhe do t'i ngriste llogaridhënien
- ☑ Institucionet përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, përfshirë KQZ-në dhe KKZ-të, duhet të jenë më transparente për punën e tyre. KQZ-ja duhet që brenda periudhave më të shkurtra kohore të publikojë të gjitha vendimet dhe procesverbalet e miratuara gjatë mbledhjeve. Në anën tjetër, KKZ-të duhet që t'i bëjnë publike lajmërimet për mbajtjen e mbledhjeve, si dhe të publikojnë vendimet dhe procesverbalet e tyre.
- ☑ Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve, i Sekretariatit të KQZ-së, duhet që të vazhdojë të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e informacioneve dhe përmbajtjen e produkteve informuese të cilat plasohen në publik. Fokus i shtuar duhet t'i dedikohet plasimit të fushatave informuese dhe vetëdijësuese në rrjetet sociale dhe metodave më inovative dhe efikase;
- ☑ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përkatësisht KKZ-të, duhet të monitorojë në vazhdimësi zbatimin e dispozitave ligjore gjatë ditës së zgjedhjeve, nga ana e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve. Në këtë drejtim, me qëllim të përmirësimit të procesit të administrimit të zgjedhjeve, edhe subjektet politike duhet të nominojnë persona më të kualifikuar dhe integritet për anëtarë të KVV-ve;
- ☑ Subjektet politike duhet që të punojnë në nxitjen e pjesëmarrjes së grave nëpër të gjitha sferat procesin zgjedhor, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të tyre në garën zgjedhore si kandidatë, pjesëmarrjen gjatë fushatës zgjedhore, si dhe pjesëmarrjen në organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor, meqenëse numri i tyre mbetet i ulët;
- ☑ Masa ndëshkuese duhet të zbatohen ndaj subjekteve politike, përkatësisht kandidatëve të tyre, për rastet e abuzimit me resurset publike apo ato humane, duke i përdorur ato për qëllime të fushatës elektorale;
- ☑ - Subjektet politike duhet t'i përfshijnë në mënyrë të vazhdueshme dhe aktive personat me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore, duke ofruar hapësirë për kandidimin e tyre dhe platformat specifike, përfshirjen e tyre në organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, si dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në fushatën elektorale. Në këtë drejtim, siç edhe përcaktohet me ligj, subjektet politike duhet që përkujdesen që, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të fushatës zgjedhore dhe prezantimit të programeve, të ofrohet qasje për personat me aftësi të kufizuara.

SHTOJCË – REZULTATET E KANDIDATËVE NË KATËR KOMUNAT VERIORE

Rezultatet përfundimtare për zgjedhjet në katër komunat veriore janë shpallur më 23 maj, ndërsa të njëjtat janë certifikuar më 27 maj.

REZULTATET PËRFUNDIMTARE, TË NDARA SIPAS KOMUNAVE, JANË SI NË VIJIM:

Leposaviq

60. Lëvizja Vetëvendosje – Fisnik Veseli

→ 105 vota / **1.4%**

61. Partia Demokratike e Kosovës – Shaqir Hetemi

→ 144 vota / **1.9%**

62. Srpska Lista – Zoran Todić

→ 7,296 vota / **96.7%**

Zveçan

60. Lëvizja Vetëvendosje – Avdi Peci

→ 82 vota / **2.0%**

61. Partia Demokratike e Kosovës – Ilir Peci

→ 131vota / **3.2%**

62. Srpska Lista – Vučina Janković |

→ 3,847 vota / **94.8%**

Zubin Potok

60. Lëvizja Vetëvendosje – Liridona Kahrmani

→ 110 vota / **2.6%**

Partia Demokratike e Kosovës – Hysen Mehmeti

→ 123 vota / **2.9%**

62. Srpska Lista – Srdjan Vulović

→ 4,075 vota / **94.6%**

Mitrovicë e Veriut

60. Lëvizja Vetëvendosje – Erden Atiq

→ 331 vota / **4.0%**

61. Partia Demokratike e Kosovës – Gonxhe Çausi

→ 461 vota / **5.6%**

62. Srpska Lista – Goran Rakić

→ 7,484 vota / **90.4%**

MBËSHTETUR NGA:

